



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.06.2016, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK–03-02/1162/16, për zyrtarin e lartë z. Ramiz Kelmendi, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, ne ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marrë nga mediat e shkruara është nxjerr vendimi me nr. AKK–03-02-1162/16 për fillimin e shqyrtimit e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Ramiz Kelmendi, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas informatave fillestare është thënë se Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi për ofrimin e praktikës profesionale në ndërmarrje për nxënësit e shkollave profesionale në gjithë vendin me kompaninë “Elkos Group” e cila është pronë e z. Ramiz Kelmendi, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit duke vepruar sipas kompetencave dhe mandatit që ka, ka grumbulluar informatat zyrtare të ofruara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (DPK/DPKI 03-02/1520/16).

Pasi janë analizuar me kujdes provat dhe materialet që kemi pasur në dispozicion (Marrëveshja e bashkëpunimit për ofrimin e praktikës profesionale në ndërmarrje për nxënësit e shkollave profesionale në gjithë vendin me kompaninë “Elkos Group”, është vërtetuar se kjo marrëveshje është nënshkruar nga Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami dhe zëvendës Presidenti i Kompanisë “Elkos Grup” z. Fatos Islami.

Duke u bazuar në këtë fakt si dhe në përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj marrëveshje kemi konstatuar se zyrtari i lartë z. Ramiz Kelmendi, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk gjendet në situatë të konfliktit të interesit për arsye se zyrtari i lartë nuk ka pas rol vendimmarrës në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe se kjo marrëveshje është nënshkruar nga personi i autorizuar i kompanisë “Elkos Grup”.

Pronësia në një biznes nga zyrtari i lartë nuk është i ndaluar dhe nuk paraqet mos pajtueshmëri ose kufizim në ushtrim të funksionit publik.

Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pas vlerësimit të provave dhe materialeve që i kemi pasur në dispozicion lidhur me këtë rast konstatohet se nuk kemi elemente faktike të gjendjes së konfliktit të interesit të paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

